



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.487/ 6 Prot

Datë 02.03.2026

V E N D I M

Nr. 320 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.03.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit së “E Hapur”, me Nr. REF-75576-02-09-2026, me objekt: Blerje paisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), me fond limit në vlerën: 10,471,893 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar me datë 27.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

Ankimues: Operatori ekonomik “Optima Communication” ShPK, Nipt. K71903025A, Adresa: Rr. Shyqyri Bërxolli, P. Inter Co-Sat, Seksioni B, Kati i 6, Nr. 6/5, Dera 28B, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Shkodër.
Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 – Shkodër.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766 datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10.02.2026 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*E Hapur*”, me Nr. REF-75576-02-09-2026, me objekt: Blerje paisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), me fond limit në vlerën: 10,471,893 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar me datë 27.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

II.2. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor, është depozituar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6335, datë 16.02.2026 dhe me Nr.487/2026 Prot., date 16.02.2026 e operatorit ekonomik “Optima Communication” ShPK, për procedurën e prokurimit sipërcituar.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me modifikimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit sipërcituar.

II.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimesit.

II.4. Me shkresën ardhur në Sistem nr.3900/4 Prot., datë 23.02.2026 protokolluar me tonën me nr. 487/1 prot., datë 23.02.2026, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

Nga shqyrtimi i informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe me Vendimin e KSHA-së ka vendosur pranim të pjesshëm të ankesës.

II.5. Me shkresën ardhur në Sistem protokolluar me tonën me nr. 487/2, datë 25.02.2026 me objekt Formular i Argumentave, operatori ekonomik ka kundërshtuar vendimin e KSHA-së mbi trajtimin e ankesës.

II.6. Me shkresën, ardhur me shërbim postar, me nr. 3900/5 Prot., datë 24.02.2026, me objekt Informacon, Autoriteti Kontraktor ka përcjellë kërkesë për vendimmarrje nga KPP.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues dhe dokumentacionit të dosjes administrative,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Optima Communication” ShPK i cili argumenton se:

Pika 1, [...] ne njoftimin e kontrates eshte percaktuar Fondi Limit 10,471,893 L.pa TVSh i detajuar mesa shohim ne kete procedure marrin pjese dy drejtori, secila me fond te vecante, ndersa ne dokumentat e tenderit eshte publikuar vetem nje liste, e cila ndoshta eshte lista permbledhese. Ju lutemi sakesoni listat, publikoni listat e seciles drejtori, si edhe konfirmoni listen permbledhese, pasi keni kerkuar qe OE te mos tejkalojne fondin e seciles drejtori dhe nuk mund ta zbatojme dot kete kerkese persa kohe nuk keni publikuar listat dhe sasite per secilen drejtori.[...]

- Autoriteti Kontraktor me Shkresën “Kthim përgjigje operatorit ekonomik ankimues”, ka përcjellë Vendimin e KSHA-së “Mbi shqyrtimin e pretendimeve të ngritura në Ankesë” të cilat janë pranuar pjesërisht me arsyetimet si vijon:

Në lidhje me sa pretendohet në ankesë, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës arsyeton si më poshtë:

Pika 1

Argumenti 1

Në lidhje me pretendimin e parë për formularin e ofertës sqarojmë se:

Pretendimi juaj qëndron pasi nuk është ndarë preventivi sipas drejtorive në DST, në këto kushte kërkesa juaj qëndron.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës vlerësojmë se pretendimi i paraqitur nga ana juaj qëndron.

Pika 9 Në dokumentin: Procesverbal_mbi_hartimin_e_specifikimeve_teknike_2026 kerkohet:

Për Artikullin 5. KOMPJUTERA Desktop 2

ARGUMENT 9.3

Ne specifikimet teknike kerkohet Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”: OEM Windows 10 64-bit Professional.

Ne linkun:

<https://support.microsoft.com/en-us/windows/windows-10-support-has-ended-on-october-14-2025-2ca8b313-1946-43d3-b55c-2b95b107f281>, do te evidentoni qe ky sistem operimi ka mbaruar suportin ne date 14 Tetor 2025.

Kerkojme nga AK, te heqe kerkesen per Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”: OEM Windows 10 64-bit Professional dhe te kerkoje sistem operimi: Windows 11 Pro 64-bit.

KSHA vendos - Kërkesa në lidhje me Sistemin e operimit pranohet.

Pika 10, Në dokumentin: Procesverbal_mbi_hartimin_e_specifikimeve_teknike_2026 kerkohet:

Për Artikullin 6. Kompjutera Workstation (Sipas Prodhuesit)

ARGUMENT 10.3

Ne specifikimet teknike kerkohet Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”: OEM Windows 10 64-bit Professional për Workstation.

Ne linkun:

<https://support.microsoft.com/en-us/windows/windows-10-support-has-ended-on-october-14-2025-2ca8b313-1946-43d3-b55c-2b95b107f281>, do te evidentoni qe ky sistem operimi ka mbaruar suportin ne date 14 Tetor 2025.

Kerkojme nga AK, te heqe kerkesen per sistemin e Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”: OEM Windows 10 64-bit Professional dhe te kerkoje sistem operimi: Windows 11 Pro 64-bit.

KSHA vendos - Kërkesa në lidhje me Sistemin e operimit pranohet.

Pika 11, Në Dokumentin: Procesverbal_mbi_hartimin_e_specifikimeve_teknike_2026 kerkohet:

Për Artikullin 7. KOMPJUTERA Workstation Advanced (Sipas Prodhuesit)

ARGUMENTI 11.3.

Ne specifikimet teknike kerkohet Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”: OEM Windows 10 64-bit Professional për Workstation.

Ne linkun:

<https://support.microsoft.com/en-us/windows/windows-10-support-has-ended-on-october-14-2025-2ca8b313-1946-43d3-b55c-2b95b107f281>, do te evidentoni qe ky sistem operimi ka mbaruar suportin ne date 14 Tetor 2025.

Kerkojme nga AK, te heqe kerkesen per sistemin e Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”: OEM Windows 10 64-bit Professional dhe te kerkoje sistem operimi: Windows 11 Pro 64-bit.

KSHA vendos - Kërkesa në lidhje me Sistemin e operimit pranohet.

Pika 12, Në Procesverbal_mbi_hartimin_e_specifikimeve_teknike_2026_pdf kerkohet:

Për Artikullin 8. LAPTOP Basic.

ARGUMENT 12.1 Ne specifikimet teknike kerkohet Sistemi i Operimit Preinstalled Licensed O. S.:OEM Windows 10 64-bit Professional. Ne Linkun: <https://support.microsoft.com/en-us/windows/windows-10-support-has-ended-on-october-14-2025-2ca8b313-1946-43d3-b55c-2b95b107f281>, do te evidentoni qe ky sistem operimi ka mbaruar suportin ne date 14 Tetor 2025.

Kërkojmë nga AK, të heqë kërkesë për sistemin e Operimit Preinstalled Licensed O. S.: OEM Windows 10 64-bit Professional dhe te kerkoje sistem operimi: Windows 11 Pro 64-bit.

KSHA vendos - Kërkesa në lidhje me Sistemin e operimit pranohet.

~~Në analizë të fakteve, në cilësinë e-zyrtareve të caktuar për shqyrtimin e ankesës, referuar~~
~~parashtrimeve të mësipërme dhe në mbështetje të nenit 114, të ligjit nr. 162/2020 "Për~~
~~Prokurimin Publik",~~

1. Të pranojmë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik **“OPTIMA COMMUNICATION”** për procedurën e prokurimit me objekt: **Blerje pajisje te Teknologjise se Informacionit dhe Komunikimit (TIK).**

III.1.1. Referuar Nenit 30 i Ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.1.2. Neni 115 pika 1 dhe 3 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar i cili parashikon shprehimisht se:

Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.”

III.1.3. Për sa më sipër, referuar nenit 115 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, vendos të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Optima Communication” ShPK për procedurën e prokurimit “E Hapur”, me Nr. REF-75576-02-09-2026, me objekt: Blerje paisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), me fond limit në vlerën: 10,471,893 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar me datë 27.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

Autoriteti kontraktor të modifikojë specifikimet teknike sipas Vendimit të KSHA-së, duke i pasqyruar të gjitha me shtojcë.

Komisioni do të vijojë me shqyrtimin në themel për pretendimet e tjera të ngritura në ankesë.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Optima Communication” ShPK, mbi modifikim të shtojcës 8, si vijon:

Kriterit 2.3.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi/distributori i autorizuar për tregtimin e artikujve TIK objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributorë të autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Pika 2.1 [...]Pjesa me e madhe e produkteve janë kerkuar ne kete procedure me sasi minimale 1 - 2 -3 -4 cope. Keto janë pajisje te llojeve te ndryshme qe i perkasin prodhuesve apo distributoreve te ndryshem, dhe eshte shume e veshtire per ne si OE qe te marrim autorizime per sasi kaq te vogla, duke na krijuar pengese per ofertimin. Duhet te kemi parasysh qe pajisjet elektronike nuk prodhohen ne Shqiperi.

Nderkohe eshte kerkuar paraqitja e katalogeve per keto produkte, dokument i cili siguron AK se janë plotësuar specifikimet teknike të kerkuara. Ne kataloget e produkteve tregohet qartesisht marka, prodhuesi, modeli, detajet teknike të produktit, pra për AK behet krejtësisht e qarte se cili është produkti i ofertuar dhe prodhuesi i tij.

Kerkojmë qe autorizimet te kerkohet vetem per zerat qe kane sasi me te medha ne kete procedure dhe te mos kerkohen autorizime per zera qe kerkohen me sasi minimale. [...]

Pika 2.2 .. lutemi te saktësohet kriteri dhe te kerkohet qe ne dokumentin qe provon lidhjen mes distributorit te huaj dhe prodhuesit, te jete e shprehur qe ky distributor i huaj ka te drejta shitje ne Shqiperi. Ne cdo marreveshje qe behet mes distributoreve dhe prodhuesve, shenohet se ne cilat shtete ka te drejta shitje ai distributor, prandaj ky eshte nje informacion qe e zoterojne te gjithë distributoret. Ne formen qe ka kriteri lejon OE te marrin autorizime nga distributore te huaj me seli ne Itali, Greqi, Serbi etj, te cilet nuk kane fare te drejta shitje ne Shqipëri.

Pika 2.3. Në listen e produkteve gjendet produkti Mainboard Genuin për Server Fujitsu PRIMERGY RX2530 M5 në cope 1. Se pari ky produkt nuk është pajisje, por pjese zëvendësuese për nje server. Duke qene se AK e kerkon specifikisht te markes Fujitsu, lutemi te mos kerkohet autorizim prodhuesi pasi kjo jo vetem kufizon konkurrencen, por i referohet specifikisht vetem nje marke te caktuar.

III.2.1 Autoriteti kontraktor ka publikuar Shtojcën 8, 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit, 2.3 Kapaciteti teknik,

2.3.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi/distributori i autorizuar për tregtimin e artikujve TIK objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributorë të autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për mallrat e furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion përkatës. Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi

përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Në këtë kontekst, referuar natyrës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dëshmime nga prodhuesi për pajisjet/artikujt e ofruara, e cila është vendosur në përputhje me Specifikimet Teknike të procedurës, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Ky kriter lidhet gjithashtu me cilësitë e artikujve dhe nevojës për garanci mbi eficientë dhe kapacitetet teknike të pajisjeve/ artikujve.

2.3.3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit (të përkthyer dhe noterizuar) për produktet TIK që janë objekt prokurimi. Në katalog, të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme produktet që ofertojnë sipas ofertës teknike të OE Ofertues dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të produkteve që janë objekt i prokurimit me qëllim që autoriteti kontraktor të vlerësojë nëse produktet e ofruar plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Argumentimi: Kriteri i vendosura në DST është vendosur për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë produktet, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike si dhe është në përputhje me piken 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

III.2.2. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik” thuhet se: “1.Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

Referuar nenit 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik”, “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1 Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

III.2.3. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim llojin e procedurës së prokurimit, me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit, fondin limit dhe sasite e mallrave.

Është detyrë e njërive përkatëse të mirëargumentojnë kriteret për kualifikim me qëllim që të jenë sa më të plota dhe të sakta që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë besueshmërinë në eksperiencat e tyre, seriozitetin në aktivitetin që kryejnë.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin/apo vendosjen e kriterëve ligjvënës i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Referuar objektit të prokurimit, dokumenteve të tenderit si edhe kriterëve për kualifikim, **pika 2.3.2** dhe **2.3.3** Autoriteti kontraktor ka vendosur dy kriterë kualifikues me qëllimin për t'u siguruar dhe verifikuar cilësinë, origjinalitetin dhe parametrat e pajisjeve objekt prokurimi.

Referuar ankesës së operatorit ekonomik i cili ndër të tjera argumenton saktë kërkesën mbi modifikime të kriterit 2.3.2 në lidhje me mallrat për të cilët duhet të kërkohet Autorizim prodhuesi ose Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi, Komisioni vëren se Autoriteti kontraktor ka kërkuar

Autorizim prodhuesi për të gjithë artikujt edhe pse pjesa më e madhe është në sasi të vogël, duke u bërë objekt ankimi nga operatorët ekonomikë.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përgjigje të testit të proporcionalitetit, Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë në kriter që operatorët ekonomikë të disponojnë autorizimin e prodhuesit **për pajisjet e kërkuara në numër të madh apo me rëndësi të veçantë**, ndërsa për artikujt e tjerë AK ka mundësi verifikimi nëpërmjet kërkesës në kriterin **2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog për mallrat [...]**

Komisioni gjykon, se është në të drejtën e operatorëve ekonomikë të bëjnë ankesa dhe t'i argumentojnë ato, në lidhje me dokumentacionin e procedurës së prokurimit se si ndikojnë në procesin e dorëzimit të ofertave në procedurën e prokurimit objekt gjykimi. Nga ana tjetër, Komisioni konstatoi, se referuar dokumenteve të procedurës, Autoriteti Kontraktor nuk ka arritur të argumentojë qartë, përse është e nevojshme paraqitja e Autorizim nga Prodhuesi/distributori i autorizuar, për të gjithë artikujt objekt prokurimi duke u bërë objekt ankimi nga operatorët ekonomikë.

Përsa analizuar në dokumentet e dosjes Komisioni gjykon, se AK duhet të modifikojë kriterin 2.3.2. duke kërkuar që ofertuesit të paraqitin dokumentacionin e kërkuar vetëm për ata artikuj që janë kërkuar në sasi më të madhe, sipas shtojcën 3 “FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT” sa i takon autorizimit të prodhuesit/distributorit të autorizuar, duke garantuar autoritetin kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës objekt - prokurimi.

Në lidhje me kërkesën e operatorit ekonomik ngritur në Pikën 2.3 me pretendimet:... *Në listen e produkteve gjendet produkti **Mainboard Genuin per Server Fujitsu PRIMERGY RX2530 M5 cope 1**. Se pari ky produkt nuk eshte pajisje, por pjese zevendesuese per nje server. Duke qene se AK e kerkon specifikisht te markes Fujitsu, lutemi te mos kerkohet autorizim prodhuesi pasi kjo jo vetem kufizon konkurencen, por i referohet specifikisht vetem nje marke te caktuar*, Komisioni vlerëson të drejta argumentet mbi heqjen e artikullit nr.21, *Mainboard Genuin per Server Fujitsu* nga lista e artikujve përsa i takon kriterit 2.3.2.

Komisioni në vijim të qëndrimit të shprehur më sipër, mbi modifikim të kriterin 2.3.2 gjykon të drejtë pretendimin e operatorit ekonomik, mbi heqjen e këtij artikulli nga lista e artikujve për paraqitje të autorizimit të prodhuesit/distributorit të autorizuar.

Autoriteti të modifikojë kriterin objekt ankimi mbi kërkesën për paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose të Distributorit të autorizuar vetëm për artikujt në numër të madh apo me rëndësi të veçantë.

Përsa argumentuar pretendimet e operatorit ekonomik për nënpikat 2.1 dhe 2.3 të ankesës qëndrojnë.

III.2.4. Në lidhje me pretendimet e shprehura në ankesë, në nënpikën 2.2 argumentuar ... *Lutemi te sakesohet kriteri dhe te kerkohet qe ne dokumentin qe provon lidhjen mes distributorit te huaj dhe prodhuesit, te jete e shprehur qe ky distributor i huaj ka te drejta shitje ne Shqiperi....._Ne formen qe ka kriteri lejon OE te marrin autorizime nga distributore te huaj me seli ne Itali, Greqi, Serbi etj, te cilet nuk kane fare te drejta shitje ne Shqipëri,*

Komisioni në shqyrtim të kriterit vëren, se Autoriteti kontraktor ka hartuar kriterin me qëllim që të sigurohet mbi blerjen e mallrave në cilësinë e këkuar, në përmbushje të specifikimeve teknike dhe

hartimi i kriterit në formën e caktuar, përvec listës së artikujve që duhet të plotësohet, është i formuluar drejtë dhe nuk cënon apo kufizon konkurrencën, në të kundërt formulimi i kriterit në këtë formë hap konkurrencën mbi përfitimën e mallrave që tregëtohen, duke mos kufizuar distributorët të cilët mund t'i përkasin rajonit me mallra me cilësinë dhe funksionet e kërkuar.

Pretendimet e operatorit ekonomik nuk qëndrojnë për nënpikën 2.2.

III.3. Në lidhje me pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik në Pikën 3, mbi modifikim të kritereve kualifikuese e konkretisht argumentuar:

Në kriterin 2.3.6 Operatori ekonomik duhet të deklarojë që paisjet e ofertuara nuk janë të asbluara në Shqipëri. Të gjitha pajisjet duhet të jenë BRAND.

AK në shkelje të nenit 36 të LPP ka vendosur kërkesën për BRAND. Në mënyrë të padiskutueshme LPP nuk lejon AK-ne, të kenë referencë/kërkesë/premendime për asnjë lloj marke/brandi. Në asnjë mënyrë marka nuk duhet të jetë kriter për kualifikim apo vlerësim të OE. Termi Brand nuk është as në gjuhën shqipe. Lutemi AK-se të respektojnë gjuhën e zhvillimit të tenderit, e cila është gjuha shqipe.

Lutemi të hiqet ky kriter.

III.3.1. Autoriteti kontraktor ka publikuar Shtojcën 8, 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, **kriterin 2.3.6** Operatori ekonomik duhet të deklarojë që paisjet e ofertuara nuk janë të asbluara në Shqipëri. Të gjitha pajisjet duhet të jenë BRAND.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion pajisjet e kërkuara për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

III.3.2. Referuar nenit 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik”, “ 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “I Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

III.3.3. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 3 dhe 8 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: **3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.**

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

III.3.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Për autoritetin kontraktor është tepër e rëndësishme që të sigurohet që mallrat objekt prokurimi të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, janë në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kriteret fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë, se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) *në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës* (ii) *Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.* Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese por mbi të gjitha të mirëargumentuara dhe të formuluar saktë.

III.3.5. Referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues të paraqitur në ankesë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se pasi mori në shqyrtim argumentet e ankimuesit për **kriterin 2.3.6.** si edhe nga shqyrtimi në tërësi i dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, vëren se

kriteri rezulton i pa qartë apo i formuluar jo saktë dhe se autoriteti kontraktor duhet të japë sqarime në lidhje me se çfarë konkretisht kërkon të shprehë me kërkesën e tij. Në këtë kuptim, në kushtet kur dokumentet e procedurës së prokurimit përbëjnë shkak për ankesa në lidhje me paqartësi në dhënien e informacionit të nevojshëm për të përgatitur një ofertë të saktë në lidhje me procedurën e prokurimit objekt - ankimi, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në rastin konkret, duhet të japë sqarime të mëtijshme, duke plotësuar kriterin, sqaruar termat e përdoruar si edhe ti përkthejë në gjuhën shqipe, duke mbajtur në konsideratë pretendimet e ankimuesit por edhe referuar DST-së mbi gjuhën e caktuar përsa i përket hartimit të dokumenteve të procedurës së prokurimit.

Për sa referuar Komisioni gjykon, se AK në përputhje me nenin 75 “Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, indryshuar, duhet të publikojë sqarimet përkatëse në SPE mbi ndryshime të dokumenteve të tenderit.

Për sa më sipër pretendimet e ankimuesit qëndrojnë pjesërisht.

III.4. Në lidhje me pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik në Pikën 4 dhe Pikën 5 mbi modifikim të kriterëve kualifikuese e konkretisht argumentuar:

Pika 4: Ne Kriteret e Vecanta per Kualifikim AK ka kerkuar: 2.3.7 *Operatori ekonomik duhet të deklarojë që në pajisjet që do të ofertojë nuk është ndërhyrë për të ndryshuar konfigurimet hardëare dhe softëare. Konfigurimet hardëare dhe softëare të pajisjeve, duhet të jenë ato të prodhuesit.*

Argument 4.1 Per shumicen e artikujve AK ka kerkuar specifikime te shtuara,(RAM, HDD etj) gje qe realizohet vetem duke bere konfigurim te pajisjes. Kerkesa e mesiperme ku AK thote se nuk lejon konfigurim te pajisjeve bie ne kundërshtim me specifikimet e produktit, ku nevojitet patjetër konfigurim. AK nuk ka asnjë të drejtë të bëjë kërkesa që ndikojnë direkt te prodhuesi dhe aq me tepër sasia që kjo AK kërkon është aq minimale sa nuk mund ti kërkojë prodhuesve asnjë shërbim/konfigurim specifik. Per sa sqaruar me lart, lutemi te hiqet kriteri 2.3.7 pasi konfigurimi është i nevojshëm per realizimin e procedures sipas specifikimeve qe vete AK ka vendosur. Argument 4.2 OE është i autorizuar nga prodhuesi/distributori, garancia do mbahet nga vete OE, dhe per çfarë arsye kërkon AK qe OE te mos ndërhyjë ne konfigurimet HË dhe SË. Lutemi AK-se qe nese nuk e argumenton dot një kërkesë te tillë, sikunder nuk e ka bere argumentimin, ta heqë.

Argumenti i dhënë ne proces-verbalin e argumentimit te kriterëve është i palogjikshëm, ne asnjë rast ligji nuk detyron OE te kene ne dispozicion pajisjet ne momentin e ofertimit. Lutemi te hiqet kjo kërkesë, pasi shkon përtej qellimit te procedures. Kriteri qe ndalon OE te bëjë konfigurime siguron deshtimin e procedures, sepse nuk lejon OE te plotësojë specifikimet e shtuara qe ka vendosur AK.

Pika 5. AK ka kërkuar kriterin 2.3.8. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë se në momentin e dorëzimit të mallit do ta shoqërojë atë me Certifikatën e cilësisë për pajisjet TIK objekt prokurimi.*

[...]duhet te sqarojme se nuk ekziston asnjë dokument qe te emërtohet Certifikata e cilesise për pajisjet TIK, AK nuk ka përcaktuar qartësisht dokumentin, kërkojme te hiqet ky kriter, pasi është i paqartë, krijon konfuzion, le hapsire per interpretime si nga OE edhe nga AK, si rrjedhojë vendos OE te kushtë te pabarabarta. Pasi OE ka paraqitur cdo detaj te produktet qe ne momentin e ofertimit, ka paraqitur marken, modelin, specifikimet, detajet teknike, per secilin produkt, dhe është

vleresuar se produkti i ofruar permbush kërkesat e procedurës, dhe është i duhuri, për çfarë shërben Certifikata e cilësisë për paisjet TIK në momentin e lëvrimin. Gjykojmë kjo certifikate nuk ka me asnjë vlerë në asnjë fazë të procedurës, dhe për më tepër as nuk e kuptojmë se çfarë certifikate kërkon saktësisht AK

III.4.1. Autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE shtojcën 8, KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, konkretisht kriteret objekt ankimi:

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të deklarojë që në pajisjet që do të ofertojë nuk është ndërhyrë për të ndryshuar konfigurimet hardware dhe software. Konfigurimet hardware dhe software të pajisjeve, duhet të jenë ato të prodhuesit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion pajisjet e kërkuara për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë se në momentin e dorëzimit të mallit do ta shoqërojë atë (paraqesë) me Certifikatën e cilësisë për paisjet TIK objekt prokurimi.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion pajisjet e kërkuara për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

III.4.2. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve specifikë, që në thelb konsiderohen si kriterë fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë, se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës objekt-prokurimi për të përcaktuar kriteret për kualifikim më të domosdoshme të pa dubluara, me qëllim që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese por të argumentuara qartë e saktë çka do të ndikojë në hartimin e kriterëve të duhura në procedurën e prokurimit,

Komisioni nga analizimi i kriterëve në përgjithësi, të vendosura nga AK por edhe në veçanti të kriterëve të ankimuar në këtë procedurë, konstaton se Autoriteti kontraktor në dokumentin Procees verbal mbi argumentimin e kriterëve kualifikues, rezulton se nuk ka argumentuar qartë se përse i shërbejnë AK –së kriteret objekt ankimi dhe si ndikojnë në plotësimin e kërkesave të autoritetit për të siguruar mallra me cilësinë e kërkuar në lidhje me funksionet e tyre. Kërkesat për disa deklaratë

të njëpanjëshme rezultojnë të tepërta, konfuze e pa vlerë, si në rastin konkret kriteret 2.3.7 dhe 2.3.8.

Komisioni gjykon se për Autoritetin Kontraktor kanë rëndësi kriteret kualifikuese për të cilat kërkohen të realizohen nëpërmjet paraqitjes së dokumenteve konkrete, që do të shërbejnë në dhënien e informacionit të saktë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike/parametrave të pajisjeve si dhe cilësisë së artikujve në tërësi objekt prokurimi. Me të drejtë operatori ekonomik argumenton në ankesë, heqjen e kriterëve 2.3.7. dhe 2.3.8 si kritere të paqarta të paargumentuara nga autoriteti kontraktor. Në përfundim të analizës së dokumenteve, Komisioni gjykon të drejta pretendimet e operatorit ekonomik dhe Autoriteti kontraktor duhet të modifikojë shtojcën duke hequr e kriterëve 2.3.7 dhe 2.3.8.

Akoma më tej Komisioni sjell në vëmendje të autoritetit kontraktor, rolin e tij në fazën e lidhjes dhe ekzekutimit të kontratës, moment ky ku AK përcakton të drejtat dhe detyrimet e vendosura midis palëve, dokumentacionin konkret bashkëlidhur saj si edhe monitoron zbatimin e kontratës së shërbimit, në përputhje me kërkesat e vendosura në DST. Në rast mospërmbushje të detyrimeve të operatorit ekonomik, AK merr masa dhe penalitete për moszbatim të kontratës.

Pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë

III.5. Në lidhje me pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik në Pikën 6 të ankesës, mbi modifikim të specifikimeve teknike e konkretisht argumentuar

PIKA 6 *Ne Njoftimin e Kontrates - Seksioni 1: Autoriteti/Enti Kontraktor, AK ka publikuar ne: 2.17 ka percaktuar se per specifikimet teknike ka perdorur specifikimet e pergatitura nga AKSHI. Theksojme se PJESA ME E MADHE E PAJISJEVE TE PROCEDURES NUK JANE SIPAS SPECIFIKIMEVE TE AKSHI-T, gje qe bie ne kundërshtim me percaktimet qe vete AK ka bere ne DST ku konfirmon se jane perdorur specifikimet e AKSHI-t. Nga ana tjetër, AK pretendon se I ka argumentuar por ne asnje pike te dokumentave te procedures, nuk gjendet asnje fjale e vetme qe te argumentojë specifikimet e vendosura duke qene ne shkelje ligjore. AK ka vendosur specifikimet tejet te ekzagjeruara duke rritur ndjeshem kostot dhe duke veshtiresuar konkurencën, pasi kerkohen pajisje me specifikime te shtuara qe rendojne pozitat e OE pa asnje argumentim te vetem. AK nuk ka dhene asnje informacion per specifikimet qe ka modifikuar, nuk ka dhene asnje informacion per fluksin e punes, sa perdorues kane keto pajisje, sa flete leter printohen ne to, cilat procese te punes te AK argumentojne specifikimet e vendosura, ne cilat procese te punes se AK do te perdoren keto pajisje dhe pse duhen specifikime kaq te rritura, cfare do te bejne punonjesit e AK gjate orarit te punes qe ju duhet pajisje kaq specifike dhe pse pajisje me specifikime AKSHI nuk e perballojne dot punen e administrates se Bashkise Shkoder, cfare do te printohet me keto printera. Sipas informacioneve te procedures keto pajisje do te perdoren nga: Drejtoria Juridike, Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve Mbeshtetese, si edhe nga Drejtoria e Kultures. Sa eshte nr i punonjesve ne keto drejtori, cfare fluksi pune kane keto drejtori dhe cfare procesi kompjuterik perdorin qe kane nevojë per specifikime kaq te rritura.*

Kerkojme qe per te gjitha pajisjet te cilat jane pjese e listes se AKSHI-t te vendosen specifikimet e miratuara nga AKSHI. Per pajisjet te cilat nuk jane pjese e listes, te argumentohet cdo specifikim i

vendosur ashtu sikurse pretendon AK se i ka argumentuar ato nderkohe qe nuk ka asnje fjale te vetme lidhur me argumentimin. Te gjitha pajisjet e meposhteme jane pjese e listes se AKSHI-t:

Asnjera nga keto pajisje nuk ka specifikime sipas AKSHI-t sikurse ka percaktuar AK ne DST. Lutemi per te gjitha pajisjet te ndryshohen specifikimet dhe te vendosen sipas specifikimeve te AKSHI-t. ARGUMENT Cdo specifikim i ekzagjeruar/shtuar shkon ne kundërshtim me percaktimin ligjor dhe kerkon nje argumentim te detajuar teknik.

- Gjithashtu Ankimuesi në **pikat 7 deri 14** ka vijuar me pretendime konkrete mbi modifikimin e Specifikimeve teknike të pasqyrura në DST.

III. 6.1 Autoriteti kontraktor ka publikuar DST në SPE **Seksioni 2** Objekti i Kontratës: “**Blerje paisje te Teknologjise se Informacionit dhe Komunikimit (TIK)**”

2.17 Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) përdoren standardet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shqërisë së Informacionit:

Po X Jo ☐

2.18. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rast se standardet nuk janë të zbatueshme, merret një miratim paraprak nga Agjencia Kombëtare e Shqërisë së Informacionit:

Po X Jo ☐

Dokumenti Procesverbal mbi hartimin e specifikimeve teknike, për parametrat objekt ankimi, dhe argumentuar si me poshtë vijon:

Dokumentin: Procesverbal mbi hartimin e specifikimeve teknike 2026.

2. FOTOKOPJE Multifunction

B&W Copy Machine A3

Karakteristikat minimale teknike	Pretendime të Ankimuesit, Pika 7 e ankesës.
Shpejtësia “Copy/Print Speed for A4 ≥35 ppm Shpejtësia e Skanimit “Scan Speed ≥250 ipm (duplex)	<i>Kombinimi i shpejtesise se printimit 35 faqe /min, me shpejtesine e skanimit 250 imazhe/min, krijon nje profil teknik te pazakonte dhe kufizon gamen e produkteve/markave qe perputhen. Kjo eliminon alternativave ne treg, Kerkojme Shpejtesi Skanimi nga 250 ne 35 ppm</i>
Document Feeder : RADE/DADF Dual Scan Document Feeder (Skanon te dyja anët e fletës me një kalim)	<i>Kerkojme te hiqet kerkesa - Skanon te dyja anët e fletës me një kalim – kufizon, nuk eshte standard.</i>
“Security Feature”: 802.1X, SMBv3, Password policy, SNMPv3	<i>Vecorite te sigurise 802.1X, SMBv3, SNMPv3 dhe password policy, nuk figurojne dhe prodhuesit nuk i deklarojnë te gjitha keto informacione ne katalog.. Mungesa e ketij specifkimi nuk do te cenoje aspak funksionalitetin e kesaj pajisjeje, nuk do ti jape vecori shtese pajisjes, Kerkojme te hiqet specifikimi.</i>
Tavoline Copier Desk: Po i te njejet Marke me Fotokopjen.	<i>Te hiqet, kerkese e pa argumentuar nuk ndikon ne funksion te pajisjes.</i>

3. FOTOKOPJE Multifunction

Color Copy Machine MFP A3

Karakteristikat minimale teknike	Pretendime të Ankimuesit Pika 8 e ankesës
Shpejtësia “Copy/Print Speed for A4, B&W ≥35 ppm Shpejtësia e Skanimit “Scan Speed ≥250 ipm (duplex)	<i>Kombinimi i shpejtesise se printimit 35 faqe /min, me shpejtesine e skanimit 250 imazhe/min, krijon nje profil teknik te pazakonte dhe kufizon gamen e produkteve/markave qe perputhen. Kjo eliminon alternativave ne treg, Kerkojme Shpejtesi Skanimit nga 250 ne 35 ppm</i>
Document Feeder : RADF/DADF Dual Scan Document Feeder (Skanon te dyja anët e fletës me një kalim)	<i>Kerkojme te hiqet kerkesa - Skanon te dyja anët e fletës me një kalim – kufizon, nuk eshte standard.</i>
“Security Feature”: 802.1X, SMBv3, Password policy, SNMPv3	<i>Vecorite e sigurise 802.1X, SMBv3, SNMPv3 dhe password policy, nuk figurojne dhe prodhuesit nuk i deklarojnë te gjitha keto informacione ne katalog.. Mungesa e ketij specifkimi nuk do te cenoje aspak funksionalitetin e kesaj pajisjeje, nuk do ti jape vecori shtese pajisjes, Kerkojme te hiqet specifikimi.</i>
Tavoline Copier Desk: Po i te njejtes Marke me Fotokopjen.	<i>Te hiqet,</i> kerkese e pa argumentuar nuk ndikon ne funksion te pajisjes.

5. KOMPJUTERA

Desktop 2

Karakteristikat minimale teknike	Pretendime të Ankimuesit, Pika 9 e ankesës
Disk Subsystem Controller: SSD M.2 NVMe, min v. 4.0, HDD Serial ATA III 6.0 Gb/s	<i>Slot PCI te gjenerates se 4.0, funksion te cilen mund ta beje njesoj edhe PCI-e I gjenerates se 3-te. AK po rrit kostot e kompjuterit ne menyre te paargumentuar. Kerkojme nga AK, te heqe kerkesen per min v. 4.0 dhe te bazohet ne specifikimet e hartuara nga AKSHI, I cili ne asnje moment nuk shprehet per versionin e slot-it.</i>
Madhësia e Hard Disk Min. 256 GB SSD (sistem operimi) Min. 2 x 1 TBHDD 7200 rpm (raid 1 data storage) Slots: Min. (3) PCI/PCI-E, nga te cilat min. (1) PCI-E 4.0 x16	<i>SSD mund te instalohet ne kete porte x16 por punon vetem ne lane x4.Pse AK kerkon nje slot i cili nuk do te shfrytezohet, por rrit kostot e kompjuterit ne menyre te paargumentuar. AK po kerkon nje porte te cilen nuk do ta perdore kurre. Rrit kostot. Te hiqet kerkesa PCI-E 4.0 x16. AK te bazohet tek AKSHI Min. (3) PCI-E, nga te cilat min. (1) PCI-E 3.0 x16 dhe min. (1) M.2 NVMe.</i>

6. KOMPJUTERA

Workstation (Sipas Prodhuesit)

Karakteristikat minimale teknike	Pretendime të Ankimuesit, Pika 10 e ankesës
Disk Subsystem Controller: SSD M.2 NVMe, min v. 4.0, HDD Serial ATA	<i>Slot PCI te gjenerates se 4.0, funksion te cilen mund ta beje njesoj edhe PCI-e I gjenerates se 3-te. AK po rrit</i>

III 6.0 Gb/s	kostot e kompjuterit ne menyre te paargumentuar. Kërkojme nga AK, te heqe kërkesen per min v. 4.0 dhe te bazohet ne specifikimet e hartuara nga AKSHI, I cili ne asnje moment nuk shprehet per versionin e slot-it.
Madhësia e Hard Disk Min. 256 GB SSD (sistem operimi) Min. 2 x 1 TBHDD 7200 rpm (raid 1 data storage) Slots: Min. (3) PCI/PCI-E, nga te cilat min. (1) PCI-E 4.0 x16	SSD mund te instalohet ne kete porte x16 por punon vetem ne lane x4. Pse AK kerkon nje slot i cili nuk do te shfrytezohet, por rrit kostot e kompjuterit ne menyre te paargumentuar. AK po kerkon nje porte te cilen nuk do ta perdore kurre. Rrit kostot. Te hiqet kërkesa PCI-E 4.0 x16. AK te bazohet tek AKSHI Min. (3) PCI-E, nga te cilat min. (1) PCI-E 3.0 x16 dhe min. (1) M.2 NVMe.

7. KOMPJUTERA

Workstation Advanced (Sipas Prodhuesit)

Karakteristikat minimale teknike	Pretendime të Ankimuesit, Pika 11 e ankesës
“Disk Subsystem Controler”: SSD M.2 NVMe (v. 4.0) Serial ATA III 6.0 Gb/s, Minimum 4 Serial ATA Interface with RAID 0,1,5,10 Support. (Hard Disk të Konfiguruar në RAID 1).	AK te heqe kërkesen per min v. 4.0 dhe te bazohet ne specifikimet e hartuara nga AKSHI, I cili ne asnje moment nuk shprehet per versionin e slot-it.
“Slots”: Minimum (4) PCI/PCI-E nga të cilat min. (2) PCI-E x16 4.0	SSD mund te instalohet ne kete porte x16 por punon vetem ne lane x4. Pse AK kerkon nje slot i cili nuk do te shfrytezohet, por rrit kostot e kompjuterit ne menyre te paargumentuar. AK po kerkon nje porte te cilen nuk do ta perdore kurre. Rrit kostot. Te hiqet kërkesa PCI-E 4.0 x16. AK te bazohet tek AKSHI Min. (3) PCI-E, nga te cilat min. (1) PCI-E 3.0 x16 dhe min. (1) M.2 NVMe.

13. Firewall

Pretendime të Ankimuesit, Pika 13 e ankesës

Lutemi AK-se te perktheje ne gjuhen shqipe, pasi gjuha e zhvillimit te tenderit eshte e tille. Ne si OE, ne rast se katalogun do ta sjellin ne gjuhen angleze, te paperkthyer ne gjuhen shqipe, do skualifikohemi nga AK.

Lutemi AK-se te mbaje standardin dhe te respektojë LPP. Specifikimet teknike duhen në gjuhen shqipe.

14. Smart TV

Karakteristikat minimale teknike	Pretendime të Ankimuesit, Pika 14 e ankesës
Refresh rate: Deri ne 144Hz Sistemi operimit: Android 8.0 ose ekuivalent	Kombimi i ketyre 5 elementeve eshte thujse i pamundur ne treg. TV me 144Hz jane modele kryesisht per lojra. Sistemi operimit Android 8.0 eshte version shume i vjeter(tani jemi ne versionin 15.0). Hyrja 4 x HDMI 2.1 eshte sh. specifike (shumica kane 2

Hyrja e videos: 4 x HDMI® 2.1; 1 x Stereo 3.5 mm; Wifi: Min. version 5 Bluetooth: Min. version 5	ose 3), nderkohe qe WiFi dhe Bluetooth kerkohen ne versionet e fundit. Lutemi AK-se te rishohe specifikimet dhe keto 5 elemente qe ajo kerkon me domosdoshmeri, ti mire-argumentoje, ndryshe ti heqe.
Frame rate $\geq$ 110 fps	Term i gabuar, ky eshte TV jo karte grafike, Specifikimi i duhur per TV eshte frekuenca dhe njesia matese eshte Hz. Lutemi AK-se ta heqe/korigjoe kete specifikim.
Audio 2 altoparlantë të integruar 30 W Tipi i sistemit te zerit - System audio 2.1	Ne gjuhen teknike jane: Audio: 2 altoparlantë 30W = sistem 2.0 System audio 2.1 do te thote: 2 altoparlante + 1 subwoofer Cilen kerkon AK, system 2.0 apo system 2.1? Lutemi AK-se te qartesoje kerkesen kontradiktore.
Jetëgjatësia: $\geq$ 50.000 orë	Prodhuesit e tv nuk deklarojne jetegjatesi. Kerkojme nga AK, te heqe kete specifikim teknik.
Funksionalite: Automatic Brightness Control; Voice recognition; Auto power off; HDCP 2,3 (Audio\Video); MultiView screens 4.0; Audio only mode; Quick Power On; Ambient mode; Digital Noise Reduction; Motion Clarity	Specifikimi HDCP 2,3 (Audio\Video) nuk shenohet nga prodhuesit ne katalog/apo skede teknike. Mungesa e ketij specifikimi ne katalog do sherbeje si arsye per skualifikimin tone. Bazuar ne sa me lart, kerkojme te hiqet ky funksionalitet.
Memoria: Min. 3 GB DDR Hapësira e ruajtjes: Min. 20 GB	Prodhuesit e TV nuk deklarojnë as RAM dhe as hapësirë ruajtje. Kerkojme nga AK, ti heqe keto specifikime teknike.

Pretendime te ankimuesit si vijon:

Bazuar sa më lart kerkojmë: Pezullimin e Procedures, Heqjen /Ndryshimin e Kriterëve / Specifikimeve Teknike te Ankimuar si më sipër për Artikujt, pasi jane pengese per ofertim, krijojne kufizim te konkurences, jane diskriminues, tejet te ekzagjeruara dhe nuk garantojne trajtim te barabarte te OE.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike nga Autoriteti kontraktor:

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 1 dhe 2, të VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standart të kërkuar. Si dhe me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor si dhe OE të marrë masat ne kohën e duhur që të garantojë kapacitetet për përmbushjen me sukses të kontratës sipas kushteve të përcaktuara. **Pjesa më e madhe e pajisjeve janë specifikuar sipas standarteve TIK të vendosura nga AKSHI

III.6.2. Neni 36, “Specifikimet teknike” të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

7. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, referuar parashikimeve të mësipërme, kryen verifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të

tjera kombëtare në rast se ekzistojnë standarde kombëtare ose ndërkombëtare në fuqi për mallrat, punët dhe shërbimet. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet evropiane.

III.6.3. Në pikën 3/c të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 703, datë 29.10.2014 “PËR AGJENCINË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT”, parashikohet se:

“3. AKSHI ka këto detyra dhe përgjegjësi specifike: c) Përcakton standardet e TIK-ut, bazuar në standardet ndërkombëtare dhe evropiane, të adoptuara, që do të ndiqen nga administrata shtetërore. Këto standarde botohen në Buletinin e Njoftimeve Publike.”.

III.6.4. Në pikën 5 të Kreut I “Të përgjithshme” të Udhëzimit të Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit Nr. 2, datë 02.09.2013 “PËR STANDARDIZIMIN E HARTIMIT TË TERMAVE TË REFERENCËS PËR PROJEKTET TIK NË ADMINISTRATËN PUBLIKE”, parashikohet se: “I. Të përgjithshme 5. Rekomandohen institucionet qendrore të pavarura, duke përfshirë ato të sistemit gjyqësor e të prokurorisë, të universiteteve shtetërore, si dhe të fondeve speciale, Njësitë e Qeverisjes Vendore, të zbatojnë këtë udhëzim gjatë hartimit të projekteve të teknologjisë së informacionit e të komunikimit, për institucionet e tyre.”

III.6.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së Lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, thuhet se: Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përfshijnë nga konkurimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtarë apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të të orientojnë operatorët ekonomikë në përgatitjen e ofertave.

Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu në vendimet e GJED arsyetohet se: “*Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e*

mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”

Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë, që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar të parashtrojnë pretendime mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110 pika 1 të ligjit.

III.6.6 Komisioni, nga shqyrtimi i DST-së së procedurës objekt gjykimi konstaton, se Autoriteti Kontraktor, në hartimin e specifikimeve teknike të pajisjeve, pjesërisht i është referuar Standardeve të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, publikuar Janar 2025, (i vlefshëm për periudhën 1 Janar 2025 – 31 Dhjetor 2025) por disa parametra janë shtuar nga AK.

Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik, mbi modifikim/heqje të parametrave të pajisjeve sipërcituar në tabelat përkatëse Komisioni gjykon se referuar VKM Nr. 703, datë 29.10.2014 “Për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” si dhe Udhëzimit Nr. 2, datë 02.09.2016 “Për standartizimin e hartimit të termave të referencës për projektet TIK në Administratën Publike”, si dhe nisur nga fakti se autoriteti kontraktor është institucion që i përket pushtetit lokal dhe që financimet janë edhe nga buxheti i shtetit, Komisioni gjykon se specifikimet teknike të hartuara nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit janë detyruese për tu implementuar nga ana e organeve të administratës shtetërore në hartimin specifikimeve/parametrave të pajisjeve TIK, aq më shumë kur vetë autoriteti kontraktor ka pranuar në DST, në pikën **2.17 Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) përdoren standardet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:**

Po X Jo ☐

2.18. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rast se standardet nuk janë të zbatueshme, merret një miratim paraprak nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:

Po X Jo ☐

Autoriteti kontraktor me Vendimin e KSHA-së nuk ka pranuar pretendimet për sa i përket gjuhës së specifikimeve teknike AK është shprehur: *se termat teknike nuk mund të përkthehen në gjuhën shqip pasi humbasin kuptimi...*

Referuar ankesës si edhe dokumenteve të procedurës së prokurimit Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar qartë dhe në mënyrë të detajuar specifikimet teknike të shtuara apo të modifikuara, jashtë referencave të AKSHI-t duke u bërë shkak për ankesa nga operatorët ekonomikë.

Komisioni gjykon se specifikimet teknike shume të detajuara të paargumentuar dhe të pa nevojshme për kërkesat e autoritetit kontraktor, ngushtojnë konkurrencën apo orientojnë drejt markave të paracaktuara apo edhe operatorëve të vecantë, duke vendosur në vështirësi operatorët ekonomikë të cilët janë të interesuar për pjesmarrje në këtë procedurë.

Me të drejtë ankimesi argumenton pretendimet e tij, se AK nuk ka bërë një analizë të qartë të nevojës, të përlllogaritjeve mbi materialet që do të printohen apo fotokopjohen e skanohen me qëllimin për të përcaktuar specifikimet/parametrat e pajisjeve objekt prokurimi apo dhe qëllimin

për të cilin do të përdoren në autoritetin kontraktor.

Komisioni në analizë të fakteve të dosjes administrative gjykon, se Autoriteti kontraktor duhet të argumentojë qartë specifikimet teknike në tërësi por edhe ato të ankimuara në vecanti, të japë sqarime të nevojshme si edhe të vlerësojë kërkesat për përkthimin në gjuhën shqipe për parametrat e ankimuara dhe jo vetëm.

Komisioni gjykon se Autoriteti duhet të modifikojë specifikimet teknike objekt ankimi duke përcaktuar: Qartë dhe Saktë mbi vendosje të parametrave kryesorë të pajisjeve dhe **duhet ti vendosi ato sipas AKSHI-t**, për të orientuar drejtë operatorët në ofertimet e tyre për këtë procedurë, pa përshtatur parametra të cilët janë shumë të hollësishëm dhe të tepruara të cilat nuk japin informacionin e duhur për pajisjet objekt ankimi por që të çojnë drejt markave të përcaktuara. Përsa arsyetuar më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë dokumentat e tenderit dhe konkretisht procesverbalin “PËR ARGUMENTIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE” të publikuar në SPE duke argumentuar qartë dhe saktë vendosjen e specifikimeve teknike dhe Shtojcën e Specifikimeve Teknike/Parametrave të artikujve në dokumentet e tenderit, duke modifikuar parametrat sipas pretendimeve të ankimuesit, duke ju referuar specifikimeve standarde të miratuara nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për vitin 2025 përsa kohë ka përcaktuar në DST **pika 2.17 sipërcituar.**

Për specifikimet teknike mbi aksesoret siç janë tavolinat e të njejtës markë: Komisioni gjykon se AK duhet ti hiqi përcaktimi sipas markës së pajisjes duke vendosur parametrat më të nevojshëm me qëllim për të hapur konkurrencën për të mos orientuar drejt markave të paracaktuara.

Përsa i përket pretendimeve mbi gjuhën e përdorur në specifikimet teknike Komisioni gjykon se gjuha e përdorur në procedurën e prokurimit, përcaktuar në DST është gjuha shqipe sipas pikës së DST 4.7Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat: Shqip X Anglisht ☐ , si në hartimin e dokumenteve të tenderit edhe në përpilimin e ofertave të operatorëve ekonomikë.

Ne përfundim të arsyetimit Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumente të tenderit sipa konstatimeve sipërcituar.

Pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë pjesërisht .

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Optima Communication” ShPK për procedurën e prokurimit “E Hapur”, me Nr. REF-75576-02-09-2026, me objekt:

Blerje paisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), me fond limit në vlerën: 10,471,893 Lekë pa TVSH, për t'u zhvilluar me datë 27.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

2. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera me publikimin e shtojcës në zbatim të Vendimit të KSHA-së dhe konstatimeve të këtij vendimi.

3. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues "Optima Communication" ShPK.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

